



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivory	02.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKMBICK	1125/2022		117



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.45/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.45/2022 të datës 21.01.2022 të parashtruar nga ankuesi [] të cilin me autorizim e përfaqëson firma [] dhe me Avokat [] Urim [] me adresë []

[] në Prishtinë, kundër Vendimit me numër 164/2021 të datës 22.12.2021 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 02/03/2022 mori këtë

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa më numër A.nr.45/2022 e datës 21.01.2022 e parashtruar nga ankuesi []

II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. 164/2021 i datës 22.12.2021 i Ministres së Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës.

III. OBLIGOHET Ministria e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin [] në pozitën Drejtor në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 20.09.2021 ka nxjerr vendim me Nr.01058 për formimin e Komisionit Hetimor për hetim të brendshëm administrativ lidhur me dyshimet e ngjarjes në Qendrën Korrektues për të Mitur në Lipjan për një ngacmim nga ana e një arsimtari të ndodhur më datës 17.06.2021. Komisioni Hetimor më datë 02.11.2021 ka nxjerr Raport Përfundimtar të Hetimeve ku pas deklaratave të personave ka gjetur shkelje gjatë këtij procesi dhe ka rekomanduar Komisionin Disiplinor të ndërmarr masat disiplinore në pajtim me ligjet në fuqi.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazuar në raportin e Komisionit Hetimor, më datë 14.12.2021 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit pranë Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë, më datë 22.12.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 164/2021 me të cilin ka ankuesin e ka shkarkuar nga detyra e Drejtorit në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, ndërsa pas këtij Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 23.12.2021 ka marr Vendim me Nr.0281 me të cilin e ka përfunduar procedurën disiplinore, me arsyetimin se të njëjtit ju ka ndërprerë marrëdhënia e punës nga Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë dhe se është konsumuar objekti mbi të cilin është filluar procedura disiplinore.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 164/2021 të datës 22.12.2021 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës më datë 18.01.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 21.01.2022 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe regjistruar me numër të ankesën A.nr.45/2022 dhe Nr. Prot:281/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Më datë 09.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:: Ankesën e datës 21.01.2022 me Nr. prot:281/2022 të parashtruar nga ankuesi në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 30.12.2021; Vendimin me Nr. 164/2021 të datës 22.12.2021 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë; Deklaratën e datës 18.06.2021 nga Deklaratën e datës 18.06.2021 nga Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore e datës 14.12.2021; Emailin e datës 80.09.2021 nga ankuesi; Zarin e datës 18.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 09.02.2022; Vendimin e datës 24.09.2021 për transferim të ankuesit Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Pejë; Vendimin e datës 24.12.2019 për transferimin e ankuesit në pozitën Drejtor i Qendrës Korrektuese në Lipjan; Kontratë punë për kohë të pacaktuar; Vendimin e datës 23.12.2021 të Komisionit Disiplinor të SHKK-së; Raportin përfundimtar të Hetimeve i datës 02.11.2021; Vendimin e datës 20.09.2021 për formim të Komisionit Hetimor; Emailin e datës 16.10.2020 të ankuesit ; Emailin e datës 12.10.2020 nga Emailin e datës 12.10.2020 nga Emailin e datës 12.10.2020 nga Shënim Zyrtar i datës 18.06.2021; Deklaratën e datës 17.06.2021 nga Deklaratën e datës 18.06.2021 nga Shkresë me titull hetimi lidhur me rastin e datës 17.06.2021 ku e mitura me masë edukuese korrektuese lajmëron zyrtaren sociale dhe udhëheqësen për ngacmim nga profesioni i shkollës në QKML e datës 18.06.2021; Njoftimin e datës 80.09.2021; Raporti javor i punës prej datës 11.06.2021 deri 17.06.2021; Raporti javor i punës i SHKK prej datës 11.06.2021 deri 18.06.2021; Formulari i regjistrit të lëvizjeve të burgosurve për SHKK datë 18.06.2021; Raportin e punës i Drejtorëve të Burgjeve; emailin e datës 08.09.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 80.09.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 09.09.2020 nga Dëftesë e datës 02.07.2020; Shkresë për personin e intervistuar e datës 23.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar e datës 22.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar e datës 22.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar e datës 23.09.2021; Shkresë për personin e intervistuar e datës 22.09.2021; Emailin e datës 19.10.2021, 04.10.2021 nga për Emailin e datës 05.10.2021 nga për Forma për pushim e datës 04.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke trajtuar shkresat e lëndës fillimisht ka vlerësuar kompetencën lëndore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke marrë parasysh dispozitat ligjore në fuqi. Vendimi me Nr. 164/2021 i datës 22.12.2021 i Ministres së Ministrisë së Drejtësisë është nxjerr duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, gjegjësisht, nenin 217, i cili përcakton se: "Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen me konkurs të hapur nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me deponat për Shërbimin Civil, për emërimin, për pozitën e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. 2.Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen përshtatshëmrisht me dispozitat për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm. 3.Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen për periudhë kohore pesë (5) vjeçare me mundësi vazhdimi. 4.Detyrën e drejtorit të institucionit korrektues mund ta ushtroj personi (kandidati) i cili i plotëson kushtet në vijim: 4.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 4.2.

të ketë përgatitje universitare; 4.3. të ketë gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku tri (3) vite përvojë pune në pozita udhëheqëse; 4.4. të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike; 4.5. të ketë reputacion moral dhe profesional, dhe të mos jetë i dënuar për veprë penale. 5. Ministri vet, apo me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm mund t'i suspendoj, ose shikarkoj drejtorët e institucioneve korrektuese për shkelje ligjore apo për shkak të mos efikasitetit në punë. 6. Vendimi i Ministrit për suspendim, apo shikarkim të drejtorëve të institucioneve korrektuese është përfundimtar. 7. Institucionet korrektuese mund të kenë edhe zëvendës drejtorët, të cilët emërohen sipas procedurës, kushteve dhe kohëzgjatjes të parapara për drejtorët e institucioneve korrektuese”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ligji i lartshënuar ka hyrë në fuqi më datë 29.07.2013 dhe sipas dispozitës së lartshënuar mënyra e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është bërë sipas dispozitave të ligjit për shërbimin civil gjithashtu përshtatshëm me pozitën e drejtorit të përgjithshëm janë zgjedhur edhe drejtorët e institucioneve korrektuese. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale Nr.04/L-149 gjegjësisht nenit 230, i cili përcaktohet se: “1. Procedurën disiplinore të punësuarve (personeli civil dhe zyrtarët korrektues) brenda institucionit korrektues e udhëheq komisioni disiplinor të cilin e emëron drejtori i institucionit korrektues. Për përgjegjësinë disiplinore vendosë drejtori i institucionit korrektues, me propozimin e komisionit disiplinor. 2. Procedurën disiplinore kundër drejtorit të institucionit korrektues dhe të punësuarve në Zyrën Qendrore të Shërbimit Korrektues e udhëheq Komisioni disiplinor të cilin e emëron Drejtori i Përgjithshëm. Për përgjegjësinë disiplinore vendosë Drejtori i Përgjithshëm me propozimin e Komisionit disiplinor. 3. Kundër vendimit të shkallës së parë të nxjerrë në procedurën disiplinore mund t'i parashtrahet ankesa Drejtorit të Përgjithshëm, në afat prej tetë (8) ditësh nga data e pranimit të vendimit. 4. Për shqyrtimin e ankesave dhe dënimin e propozimeve lidhur me theksimet në to dhe për ligjshmërinë e vendimeve në procedurën disiplinore, Drejtori i Përgjithshëm formon Komisionin për ankesa. 5. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me ankesën është përfundimtar”. Sipas këtij ligji është rregulluar edhe procedura disiplinore për nëpunësit civilë dhe zyrtarët korrektues në mënyrë të veçantë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ligji Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka hyrë në fuqi me datë 29.07.2013, ndërsa Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 14.06.2010, prandaj duke pasur parasysh kohën e ligjit dhe rregullimin e ndryshëm të disa çështjeve Ligji Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka pasur epërsi në pikat të cilat kanë rregulluar ndryshe pikat e marrëdhënies së punës përfshirë edhe shkarkimin e Drejtorëve të Institucioneve Korrektuese dhe çështjet disiplinore.

Nisur nga ajo që u tha më lartë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar edhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht datën e hyrjes në fuqi, meqenëse ky ligj ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020, kështu që Kolegji, ka trajtuar statusin e ankuesit në harmoni me nenin 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka përcaktuar që: “1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe

mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime.

Bazuar në këto dispozita pasi ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, vetëm çështjet e përshkruara në nenin 4 të ligjit të lartpërmendur për të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, gjegjësisht për nëpunësit civilë munden të rregullohen ndryshe nga dispozitat e Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publikë, prandaj siç shihet nga dispozita e lartshënuar çështjet disiplinore për nëpunësit civilë të Shërbimit Korrektues të Kosovës nuk mund të trajtohen duke u thirrur në Ligjin Nr.04/L-114 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale sepse përveç Ligjit për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës edhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj është shfuqizuar siç është paraparë me nenin 85 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publikë në të cilën përcaktohet se: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj"*.

Pas shterimeve të argumenteve juridike siç është sqaruar më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ministria e Drejtësisë nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk mundet të zbatoj procedurë të veçantë disiplinore për nëpunësit civilë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përpos procedurës së paraparë në ligjin e lartshënuar, prandaj për këtë arsye Ministria e Ministrisë së Drejtësisë nuk ka mundur të bazohet në nenin 217 paragrafi 5 të Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se masat disiplinore për të punësuarit në shërbimin civil të Kosovës duhet t'i ndërmerr dhe t'i shqipton vetëm Komisioni Disiplinor sipas nenit 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe rregullores përkatëse gjegjësisht Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, referuar nenit 32 paragrafi 3 në të cilin specifikisht parashihet se: "Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji", andaj mbi bazë të dispozitave të këtij ligji ndërprerja e marrëdhënies së punës për nëpunësit civilë nuk mund të bëhet me asnjë ligj tjetër përveç këtij ligji", andaj Vendimi me Nr. 164/2021 i datës 22.12.2021 i Ministres së Ministrisë së Drejtësisë për ndërprerje të marrëdhënies së punës të ankuesit është në kundërshtim me këtë ligj.

Gjithashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr. 164/2021 i datës 22.12.2021 i Ministres së Ministrisë së Drejtësisë është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenin 52 paragrafi 1 i cili përcakton se:

“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”, sepse Ministria e Ministrisë së Drejtësisë nuk ka mundur të marr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit, sepse siç është theksuar më lartë me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, çështjet disiplinore lidhur me të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk mund të rregullohen ndryshe nga ky ligj dhe si rrjedhojë Ministria e Ministrisë së Drejtësisë në këtë rast ka vepruar pa pasur kompetencë dhe autorizime ligjore.

Prandaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka peshuar me kujdes këto prova një nga një dhe së bashku në tërësi, ka konstatuar se Vendimi me Nr. 164/2021 i datës 22.12.2021 i Ministres së Ministrisë së Drejtësisë është në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara ligjore dhe si i tillë duhet të shfuqizohet me qëllim të kthimit të ligjshmërisë.

Bazuar në këto që u thanë më lartë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nuk është lëshuar në trajtimin e fakteve lidhur me shkeljet e supozuara të ankuesit, pasi që është konstatuar se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është marrë nga organi jo kompetent.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.45/2022, datë 02/03/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Përfaqësuesit të ankuesit firmës''
- Ministres së Ministrisë së Drejtësisë;
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.